

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës dhe propozohet në kuadër të paketës fiskale 2022.

Konsolidimi i financave publike, rritja e të hyrave të buxhetit dhe ulja graduale e deficitit buxhetor e borxhit publik për vitet në vijim do të mbështeten krahas masave të tjera edhe nga hartimi dhe miratimi i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA), e cila mbështetet në dy shtylla kryesore:

- Rishikimi i politikave tatimore, duke korrigjuar përjashtimet dhe tarifat e reduktuara dhe joefektive, si dhe
- përmirësimi i administrimit tatimor e doganor. Implementimi i kësaj strategjie do të bëjë të mundur rritjen e mobilizimit të të ardhurave tatimore shtesë në buxhet, duke pasur një sistem tatimor neutral që shmang deformimet, të thjeshtë, eficient dhe të lehtë për t’u zbatuar nga tatimpaguesit.

Në këtë kuadër, lind domosdoshmëria e propozimit të projektligjit me synimin e përmirësimit të kuadrit ligjor ekzistues në fushën e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), në funksion të zbatueshmërisë së SAA-së dhe hartimit të politikave fiskale, që kanë si objektiv uljen e raportit të borxhit ndaj produktit të brendshëm bruto (PBB) në planin afatmesëm, si dhe menaxhimin e risqeve fiskale në mënyrë më efektive.

Projektligji do të afektojë sektorin bujqësor dhe do të nxisë investimet strategjike në vendin tonë.

Kësisoj, ky projektligj propozon masa të politikës fiskale që konsistojnë në:

- trajtimin me shkallë të reduktuar të TVSH-së prej 10 për qind të furnizimit të inputeve bujqësore, siç janë: plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët,

përveç hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave;

- përjashtimin nga TVSH-ja për importimin e makinerive dhe të pajisjeve në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë;
- zëvendësimin e normës së kompensimit të prodhuesit bujqësor prej 6 për qind në 0 për qind.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Strategjia afatmesme e të ardhurave shërben si një pikë kyçe për orientimin e vendimmarrjes lidhur me forcimin dhe rritjen e përqindjes së të ardhurave që mblihen në raport me produktin e brendshëm bruto. Objektivi i SAA-së është rritja e qëndrueshme e të ardhurave tatimore në raport me PBB-në, nga të cilat 50% pritet të gjenerohen si rezultat i masave që do të ndërmerren në fushën e politikave fiskale dhe pjesa tjetër nga reformat e ndërmarra në fushën e administrimit tatimor e doganor, si dhe investimeve në teknologji, për periudhën afatmesme 2022-2025, ku projekti i fiskalizimit i iniciuar gjatë vitit 2021 është elementi më i rëndësishëm i reformës në të ardhura. Ndërkohë, politikat fiskale të mirëdisenjuara do të luajnë rol të rëndësishëm në konsolidimin e financave publike, rritjen e të ardhurave dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Referuar ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në shkronjën “nj”, të nenit 51, është parashikuar të trajtohet si furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, furnizimi i inuteve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave. Ndërkohë, lista e kategorive të inuteve bujqësore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondi Monetar Ndërkombëtar, në përfundim të misionit të tij në nëntor të vitit 2019, si pjesë të rekomandimeve për reformën e politikës tatimore në Shqipëri, theksoi rishikimin me kujdes të të gjitha përjashtimeve nga TVSH-ja.

Në këtë kuadër, por edhe duke marrë në konsideratë mospërputhshmërinë e këtij parashikimi me Direktivën 2006/112/CE të Këshillit “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, është parashikuar që të shfuqizohet trajtimi i furnizimit të inputeve bujqësore si një furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja. Kështu, furnizimi i inputeve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombëtare të Mallrave, do të trajtohet me shkallë të reduktuar të TVSH-së prej 10 për qind.

Sikurse përmendet edhe më lart, furnizimi (shitja) i (e) inputeve bujqësore është një furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, sipas shkronjës “nj”, të nenit 51, të ligjit nr.92/2014, të ndryshuar, dhe, në zbatim të dispozitave të këtij ligji, subjektet që ofrojnë këtë furnizim nuk mund të zbresin TVSH-në e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, të kryera në funksion të furnizimit të përjashtuar, ndryshe nga subjektet që kryejnë furnizime të tatueshme dhe mund të zbresin TVSH-në e paguar në blerje. Trajtimi i furnizimit të inputeve bujqësore me një normë të reduktuar të TVSH-së do të kontribuojë në zbutjen e informalitetit, forcimin e ekonomisë dhe sigurimin e garancisë së produkteve bujqësore.

Në nenin 56 “Përjashtime të veçanta në import” është parashikuar që, në shkronjën “a”, të pikës 38, fjalët “... 50 milionë lekë;” të zëvendësohen me “...500 milionë lekë;”. Propozimi për zëvendësimin e vlerës 50 milionë lekë me 500 milionë lekë, lidhur me përjashtimin nga TVSH-ja në import të makinerive dhe pajisjeve që importohen në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me këtë vlerë ose me vlerë më të madhe, ka si qëllim kryesor tërheqjen e investitorëve strategjikë me vlera të konsiderueshme investimi, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen ekonomike të vendit dhe modernizimin e tij.

Gjithashtu, është parashikuar që në nenin 56, pika 38, shkronja “c”, “importimi i makinerive prodhuese nga subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.” të shfuqizohet. Ky parashikim nuk është në përputhje me Direktivën 2006/112/CE të Këshillit “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, dhe shfuqizimi i tij është në vijim të rekomandimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për të rishikuar me kujdes të gjitha përjashtimet nga TVSH-ja, të cilat nuk mbështeten mbi një argumentim të shëndoshë.

Fondi Monetar Ndërkombëtar, në përfundim të misionit të tij në nëntor të vitit 2019, si pjesë të rekomandimeve për reformën e politikës tatimore në Shqipëri, theksoi edhe heqjen e skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë dhe zëvendësimin e saj me subvencionim direkt të sektorit të bujqësisë, procedurë që është më e lehtë për t’u monitoruar e kontrolluar nga

pikëpamja fiskale. Me anë të këtij projektligji, propozohet që, norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor të bëhet 0 për qind nga 6 për qind që është aktualisht. Kjo, pasi edhe nga zbatimi në praktikë i deritanishëm, mendohet se nga skema e kompensimit, prodhuesit bujqësorë objekt të kësaj skeme, nuk kanë marrë kompensimin sikundër është parashikuar dhe ka synuar kjo skemë, duke e bërë këtë të fundit jo funksionale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*) dhe është në përputhje të pjesshme me Direktivën 2006/112/CE të Këshillit “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar. Bashkëlidhur janë edhe tabelat e përputhshmërisë, të përgatitura në gjuhën shqipe dhe angleze.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 5 nene, të cilat konsistojnë në një shtesë dhe disa ndryshime të dispozitave përkatëse të ligjit nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si më poshtë vijon:

Në nenin 1 është parashikuar që, në nenin 49 “Shkallët e reduktuara”, pas pikës 9, të shtohet pika 10, me këtë përmbajtje:

“10. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e inuteve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave, është 10 për qind. Lista e kategorive të inuteve bujqësore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2 ka parashikuar që në nenin 51 “Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm”, shkronja “nj” të shfuqizohet.

Në nenin 3 është parashikuar që në nenin 56 “Përjashtime të veçanta në import”, në shkronjën “a”, të pikës 38, fjalët “... 50 milionë lekë;” të zëvendësohen me

“...500 milionë lekë;”, si dhe shkronja “c” e saj të shfuqizohet.

Neni 4 ka parashikuar që në nenin 148 “Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor”, fjalët “...6 për qind.” të zëvendësohen me “...0 për qind.”.

Në nenin 5 është parashikuar botimi i këtij ligji në “Fletoren zyrtare” dhe hyrja në fuqi, më 1 janar 2022.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij akti ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji parashikohet të sjellë efekte financiare pozitive në buxhetin e shtetit, të cilat, sipas zërave të paraqitura në formë tabelare, vijojnë, si më poshtë vijon:

| Nr. | Propozimi | Efkti financiar në buxhetin e shtetit |
|-----|---|---------------------------------------|
| 1 | Trajtimi me shkallë të reduktuar të TVSH-së 10% i furnizimit të inuteve bujqesore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave. | 900 milionë lekë/vit. |
| 2 | Përrjashtimi nga TVSH-ja në import për makineritë dhe pajisjet e importuara në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë. | 200 milionë lekë/vit. |

| | | |
|---|--|-----------------------|
| 3 | Shfuqizimi i përjashtimit nga TVSH-ja në import për importimin e makinerive prodhuese nga subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. | 200 milionë lekë/vit. |
| 4 | Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor bëhet 0%. | 750 milionë lekë/vit. |

KËSHILLI I MINSTRAVE